**URDHËR**
**Nr. 114, datë 23.10.2012**

**PËR NOTIFIKIMIN NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE TË AVIACIONIT CIVIL (ICAO), TË NDRYSHIMEVE PËR PËRSHTATJEN E STANDARDEVE TË AVIACIONIT NË SHQIPËRI, KRAHASUAR ME ATO TË ICAO-S**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 dhe të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të dekretit të Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO)",

URDHËROJ:

1. Autoriteti i Aviacionit Civil të mbajë kontakte të vazhdueshme me strukturat përkatëse të ICAO-s dhe të marrë dijeni për ndryshimet e vazhdueshme që mund të pësojnë standardet dhe praktikat e rekomandimit të ICAO-s.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit të koordinojnë punën për inicimin e projekteve përkatëse, me qëllim përshtatjen e tyre në kuadrin ligjor rregullator të vendit tonë.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil, gjatë procesit të përgatitjes së projektakteve ligjore, të cilat adaptojnë standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil apo ndryshimet respektive të tyre, duhet të pasqyrojë në relacionin shpjegues, shmangien apo ndryshimet e qëllimshme që propozohen të bëhen nga këto standarde në përshtatje me kushtet e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

4. Autoriteti i Aviacionit Civil, pas hyrjes në fuqi të akteve ligjore të reja, si dhe për të gjitha aktet e tjera që aktualisht janë në fuqi, të cilat adaptojnë standardet e ICAO-s, të marrë masa për kryerjen e notifikimeve në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, lidhur me ndryshimet e evidentuara.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masa për publikimin në Publikimin e Informacionit Aeronautik (PIA) të Republikës së Shqipërisë të ndryshimeve të notifikuara sipas pikës 3 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi